



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1175 prot.

Tiranë, më 27. 08. 2018

Lënda: Rekomandohet marrja e masave për të garantuar pa diskriminim dhe brenda afateve efektive, të drejtën për arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përmes arsimit gjithëpërfshirës, në arsimin parauniversitar.

Znj. LINDITA NIKOLLA

MINISTRE E ARSIMIT DHE SPORTIT

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.23, Tiranë

E drejta për akses të barabartë në arsim konsiderohet si “çelësi për të arritur një fuqi më të madhe ekonomike dhe politike, dhe kështu barazi në shoqëri”. Rëndësia e të drejtës për edukim mbështetet në atë që, ushtrimi i shumë të drejtave të tjera, varët në radhë të parë nga realizimi i të drejtës për arsim, siç theksohet në *Komentin e Përgjithshëm Nr.13 (1999)*, të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, mbi të drejtën për arsim.

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹, sanksionon të drejtën e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara për të marrë një arsimim të mirë, me të njëjtën cilësi dhe në të njëjtat vende me fëmijët pa aftësi të kufizuara. Kur fëmijët me aftësi

¹ ¹Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

të kufizuara dhe fëmijët pa aftësi të kufizuara mësojnë së bashku, kjo quhet “*arsim gjithpërfshirës*”.

Arsimi gjithpërfshirës, duhet të kuptohet jo vetëm si një e drejtë e njeriut, por edhe një mjet për të realizuar të drejtat e tjera të njeriut. *Arsimi gjithpërfshirës* duhet të kuptohet si një parim që vlerëson mirëqenien e të gjithë nxënësve, respekton dinjitetin e tyre të pandarë dhe autonominë, por gjithashtu edhe rezultat I një procesi të vazhdueshëm për të eleminuar barrierat².

Siq pasqyrohet në raportin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, mbi studimin tematik për të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim, *vetëm arsimi gjithpërfshirës mund të sigurojë mosdiskriminimin në të drejtën për arsim*³.

Sipas Komentit të Përgjithshëm Nr. 4 (2016) mbi të drejtën për arsim gjithpërfshirës, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, arsimi gjithpërfshirës duhet, ndër të tjera, të ketë edhe këto karakteristika:

- Arsimi gjithpërfshirës ofron **kurrikula e metoda të mësimdhënies fleksibël, metoda mësimore të përshtatura** sipas pikave të forta, kërkesave dhe stileve të ndryshme të nxënësit. Fokusi është tek kapacitetet dhe aspiratat e nxënësve. Kjo qasje synon t'i japë fund segregimit brenda mjediseve arsimore, duke siguruar mësimdhënie gjithpërfshirëse në klasë, në mqedise të mësuarit të aksesueshëm, me mbështetje të përshtatshme. **Sistemi arsimor duhet të sigurojë një përgjigje të personalizuar ndaj nevojës për arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuar, në vend që të presë që nxënësit të përshtaten me sistemin;**
- Gjithpërfshirja ka një **qasje individuale ndaj nxënësít**.
- Të gjithë **mësuesit duhet të arsimohen dhe të trajnohen** në mënyrë që të fitojnë kapacitetet për të përshtatur një mjeshtëri gjithpërfshirës të nxënësit.
- Si një proces i vazhdueshëm, **arsimi gjithpërfshirës duhet të monitorohet** dhe të vlerësohet në mënyrë të rregullt për të siguruar që as segregimi dhe as integrimi nuk janë duke ndodhur, qoftë formalisht apo joformalisht

Sipas Komentit të Përgjithshëm nr. 6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, dështimi për t'u siguruar

² Komenti i përgjithshëm Nr. 4 (2016), mbi të drejtën për arsim gjithpërfshirës, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

³ Shiko: A/HRC/25/29 and Corr.1, paras.3 and 68.

nxënësve me aftësi të kufizuara akses të barabartë në shkollën e zakonshme me arsim gjithpërfsirës dhe cilësor përbën diskriminim.

Kuadri ligjor ekzistues garanton të drejtën për arsimim të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ky legjislacion është plotësuar me politika dhe strategji, ku parashikohen detyrime për të gjithë institucionet e përfshira në procesin e arsimimit.

Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, promovon konceptin e arsimit gjithpërfsirës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Për të garantuar arsimin gjithpërfsirës, ligji dhe aktet e tjera nënligjore, nga ku mund të përmendim Dispozitat Normative “*Për sistemin arsimor parauniversitar*” dhe udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 38, datë 07.10.2014, “*Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar*”, kanë parashikuar detyrimin për ngritjen e Komisioneve Multidisiplinare, hartimin e Planeve Edukative Individuale (PEI) sipas nevojave të vlerësuara të fëmijëvë, dhe mësuesi ndihmës.

Angazhime për të garantuar arsimin gjithpërfsirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke u fokusuar tek funksionimi i Komisioneve Multidisiplinare për të vlerësuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim, përgatitjen e Planeve Edukative Individuale (PEI) në përputhje me nevojat e fëmijës dhe vlerësimet e Komisioneve Multidisiplinare, si dhe mbështetja e nevojave me mësues ndihmës të kualifikuar, janë ndërmarrë edhe në kuadër të *Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar për periudhën, 2014-2020*⁴ dhe *Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020*⁵.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), ka ndjekur në vazhdimësi situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në sistemin arsimor. Gjatë veprimtarisë së tij, KMD, ka identifikuar problematika të ndryshme me të cilat përballen këta fëmijë, vështirësi të shumta, deri në pamundësi për t'u arsimuar.

Gjatë periudhës 2016 - 2018, rezulton në bazë të ankesave të paraqitura dhe konstatimeve të bëra nëpërmjet vendimeve të KMD, se problematikat kryesore kanë qenë në lidhje me, mosfunkcionimin e Komisioneve Multidisiplinare, mungesën e hartimit të Planeve Edukative Individuale (PEI) sipas nevojave të vlerësuara të fëmijëve, mungesën e mësuesit ndihmës. KMD ka konstatuar raste kur edhe pse formalisht ishin përmbushur detyrimet e mësipërme, ato nuk ishin efektive dhe nuk siguronin një arsim me të njëjtën cilësi si edhe për fëmijët pa

⁴ Miratuar me VKM nr. 11, datë 11.01.2016.

⁵ Miratuar me VKM nr. 483, datë 29.06.2016.

aftësi të kufizuara. Këtu, mund të përmendim rastin kur mësuesit ndihmës nuk kanë patur kualifikimet e duhura për të mbështetur në përputhje me nevojat e vlerësuara nga Komisioni Multidisiplinar për fëmijën me aftësi të kufizuara, apo mungesën e vlerësimeve mbi ecurinë në kohë të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Komisioneri, ka konstatuar se në mjaft raste situatat diskriminuese kanë ardhur si rezultat i mosnjohjes së kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe për rrjedhojë e moszbatimit të tij, ose zbatimit të gabuar.

Në respektim të standardeve ndërkontaktore dhe detyrimeve ligjore, në kuadër të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri ka konstatuar diskriminimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të drejtën e tyre për arsim, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve ligjore për Komisionet Multidisiplinare, PEI dhe mësuesit ndihmës dhe garantimin e arsimit gjithpërfshirës.

Në kuadër të misionit të tij për të siguruar mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, bazuar në kompetencën që ligji i ka dhënë Komisionerit, për të bërë rekoamndime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, si dhe me qëllim parandalimin e diskriminimit të fëmijeve me aftësi të kufizuara, për të gjuar në baza të barabarta me të tjerët të së drejtës për arsim, Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi,

R E K O M A N D O N :

- 1. Marrjen e masave të menjëhershme për të siguruar ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve Multidisiplinare në nivel DAR/ZA dhe komisioneve në institucionet arsimore të zakonshme.**
- 2. Përcaktimin e rregullave dhe procedurave për funksionimin e komisioneve si më sipër, si dhe përcaktimin e detyrimeve dhe përgjegjësive për mospërmbushjen e detyrimit për ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve Multidisiplinare, si në nivel DAR/ZA, ashtu edhe në nivel shkolle.**
- 3. Marrjen e masave të menjëhershme, për përgatitjen e **Planeve Edukative Individuale (PEI)**, sipas nevojave të vlerësuara të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga komisionet multidisiplinare.**

4. Marrjen e masave për mbështetjen me **mësues ndihmës të kualifikuar** sipas nevojave të vlerësuara të fëmijëvë me aftësi të kufizuara.
5. Marrjen e masave për të siguruar **një monitorim të vazhdueshëm dhe proaktiv** të procesit të arsimit **gjithpërfsirës**, me qëllim **eleminimin e barrierave** që pengojnë të drejtën për arsimim, të fëmijëve me aftësi të kufizuara, për të **përshtatur nevojat** dhe për të garantuar **përfsirjen efektive** të fëmijëve.
6. Marrjen e masave për të garantuar mbrojtjen nga diskriminimi në mënyrë të veçantë për **vajzat me aftësi të kufizuara**, si dhe për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuar, që i përkasin grupeve të disavantazhuara, siç janë **fëmijët me aftësi të kufizuar romë, fëmijët me aftësi të kufizuara egjiptianë, fëmijët me aftësi të kufizuara nga familjet e varfra**. Këto kategori fëmijësh janë të rrezikuar për të pérjetuar situata diskriminuese më të rënda, si **pasojë e ndërveprimit apo mbivendosjes së më shumë se një shkaku të mbrojtur**.
7. Me qëllim që të gjitha masat e mësipërme të jenë efektive, veçanërisht për vitin shkollor 2018-2019, vlerësojmë se ato duhet të realizohen në një kohë sa më të shkurtër, por **jo më vonë se fundi i muajit shtator 2018**.

Duke Ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin Tuaj, ju lutem të na informoni në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.

